



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT MBI
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT
NR. 2/2012**

5 dhjetor 2012

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloret e AAC-së, në vijim:

- Rregullore mbi rregullat e licencës së kontrollorëve të trafikut ajror dhe certifikimet tjera;
- Rregullore për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror;
- Rregullore mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror;

Këto projekt-rregullore kanë qenë në procedurë të konsultimit publik nga data 19 tetor deri më 2 nëntor 2012. Marrja e komenteve dhe vërejtjeve të palëve të interesit për këto projekt-rregullore është bërë duke aplikuar procedurën e paraparë në nenin 5.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.1/2012 (konsultimi me shkrim) duke marrë parasysh se nuk janë plotësuar kushtet për organizimin e takimit me palët e interesit, siç parashihet me nenin 5.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012.

II. QËLLIMI I NXJERRJES SË RREGULLOREVE

- **Projekt-rregullorja për rregullat e licencës së kontrollorëve të trafikut ajror dhe certifikimet tjera,**

Është nxjerrur me qëllim të përshtatjes së rregullativës së kësaj fushe me legjislacionin sekondar të BE-së. Rregullorja e Komisionit European nr. 805/2011 vendos kërkesat e përbashkëta për të gjitha vendet e BE-së, për lëshim të licencës së kontrollorit të trafikut ajror. Kjo rregullore ende nuk është pjesë formale e shtojcës I ose II të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Europiane të Aviacionit ("Marëveshja HPEA" e njohur si ECAA Agreement), të cilën Republika e Kosovës është e obliguar ta implementojë, por në bazë të nenit 3.5 (ii) të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, AAC-ja ka të drejtë që të nxjerrë rregullore për zbatim të ligjit për aviacionin civil, të cilat përfshijnë edhe rregulloret e BE-së dhe të shteteve të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil ("ICAO"). Prandaj, mbi këtë bazë është nxjerrur kjo rregullore për implementim të kërkesave të rregullores së BE-së nr. 805/2011. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret 4/2008 dhe 13/2010 të AAC-së.

- **Projekt-rregullorja për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror**

Është nxjerrur me qëllim të bartjes në rendin e brendshëm juridik të Republikës Kosovës, të Rregullores implementuese të Komisionit European nr. 1034/2011, e cila shfuqizon

Rregulloren e BE-së nr. 1315/2007, ndërsa kjo e fundit është bërë pjesë e rendit të brendshëm juridik të Republikës së Kosovës, me anë të Rregullores AAC-se nr. 13/2009.

Me këtë rregullore vendosen kërkesat për ushtrimin e funksioneve të mbikëqyrjes së sigurisë në fushën e menaxhimit të trafikut ajror dhe të shërbimeve të navigacionit ajror nga organet kompetente. Kjo rregullore shfuqizon Rregulloren e AAC-së nr. 13/2009.

- Projekt-Rregullorja mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror

Është nxjerrur me qëllim të vendosjes së kushteve për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, fushë kjo e cila ka qenë e rregulluar me Rregulloren nr. 12/2009, me atë që cilës është bartur në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregullorja e BE-së nr. 2096/2005. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e AAC-së nr. 12/2009.

III. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrja për konsultim publik të palëve të interesit i është dërguar të gjithë hisedarëve në veprimtarinë e shërbimeve të navigacionit ajror dhe më gjerë, duke përfshirë këtu edhe ANP "Adem Jashari" dhe institucionet aeronautike të Republikës së Kosovës.

Gjatë procesit të konsultimit publik, nuk është pranuar asnjë koment, qoftë nga personat fizik ashtu edhe nga personat juridik.

Raporti është hartuar nga:

Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Zyra për Çështje Juridike dhe Rregullatore